



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .05.2024

**MBLEDHJA Nr. 18,
Datë 31.05.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 31.05.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 18 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 27.05.2024.
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së ALPEX sh.a. lidhur me miratimin e procedurës së Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të asetëve të paluajtshme të saj.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW”.
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s vendim nr. 111, datë 27.03.2023, mbi licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kW.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**